

## PERFITIMET E BIZNESEVE NGA AUDITIMI I PASQYRAVE FINANCIARE

AGIM KASTRATI\*, BEKIM BERISHA

Akademia e Studimeve të Avancuara Universitare, Rruga "24 maji" nr. 15, Lagja Arbëria, Prishtinë  
Republika e Kosovës  
Email: akastrati7@hotmail.com

### PËRMBLEDHJE

Vetëdija e ulët e bizneseve për përfitimet nga auditimi i pasqyrave financiare ka ndikuar që vetëm një numër i vogël i bizneseve kosovare të bëjë auditimin e tyre. Ky numër mund të rritet nëse ngrihet vetëdija e bizneseve për përfitimet që mund t'i kenë nga auditimi. Ky studim ka për qëllim të identifikojë perceptimet e bizneseve për përfitimet e tyre nga auditimi i pasqyrave financiare. Hulumtimet e bëra nga Shelton dhe Whittington (2008) kanë treguar se vlerësimi i kontrollit të brendshëm nga ana e audituesit ka ndikim të rëndësishëm në vendimmarrje për investime. Për të qartësuar problemin është përdorur Metoda e Incidenteve Kritike, me të cilën janë identifikuar faktorët përcaktues të perceptimeve të bizneseve për përfitimet nga auditimi i pasqyrave financiare. Analiza e të dhënave të përftuara dëshmoi se ndërmarrjet e audituara janë në përparësi të konsiderueshme në krahasim me ndërmarrjet e paaudituar në pikëpamje të besueshmërisë së raporteve financiare, përmirësimit të kontrollit të brendshëm, etj. Të dhënat nga ky studim ofrojnë mbështetje empirike të studimeve të mëhershme (Shelton dhe Whittington, 2008). Studimi ofron njohuri të reja se ndërmarrjet që auditohen pasqyrat financiare përfitojnë në përmirësimin e gabimeve, zbulimin e mashtrimeve duke ndikuar kështu në rritjen e besueshmërisë së pasqyrave financiare, tërheqjen e partnerëve për investime, fitimin e granteve, kredive etj.

Fjalët kyçe: Auditimi i jashtëm, Pasqyrat financiare, Përfitimet nga auditimi

### I. Hyrje

Pasqyrat financiare të përgatitura nga menaxhmenti, për shkak të interesave të ndryshme në mes të palëve të interesuara, mund të mos paraqesin në mënyrë të drejtë gjendjen e ndërmarrjes dhe rezultatet e veprimtarisë së saj. Për këtë arsye pronarët

angazhojnë një auditues - palë e tretë e cila në mënyrë profesionale dhe të pavarur do të verifikojë saktësinë e pasqyrave financiare. Raporti i auditimit është dokument publik të cilën ndërmarrja mund ta përdorë si dokument të besueshëm dhe të paanshëm se pasqyrat financiare të sajë janë të sakta dhe pa gabime.

Çështja e auditimit në Kosovë, në kohën e këtij studimi, nuk është e rregulluar si duhet në aspektin ligjor, derisa në vendet tjera në rajon ashtu edhe më gjerë, me ligj janë përcaktuar bizneset të cilat janë të detyruara të auditohen pasqyrat financiare. Vetëdija e ulët e bizneseve për përfitimet nga auditimi i pasqyrave financiare ka ndikuar që vetëm një numër i vogël i bizneseve kosovare të bëjë auditimin e tyre. Ky numër mund të rritet nëse ngrihet vetëdija e bizneseve për përfitimet që mund t'i kenë nga auditimi.

Objektivi i këtij studimi është analiza e përfitimeve të ndërmarrjeve afariste nga auditimi i pasqyrave financiare. Për të arritur këtë objektivi na është dashur të identifikojmë perceptimet e bizneseve për përfitimet e tyre nga auditimi i pasqyrave financiare. Në këtë mënyrë kemi bërë identifikimin e faktorëve që ndikojnë te bizneset që t'i auditohen pasqyrat e tyre financiare. Duke njohur këta faktorë, kemi ardhur në përfundim se çka i nxit bizneset të auditohen pasqyrat e veta financiare.

Fillimisht ne iu kemi qasur shfletimit të literaturës e cila ka të bëjë me përfitimet e bizneseve nga auditimi i pasqyrave financiare dhe gjetjet nga literatura na kanë shërbyer si bazë në punën e mëtejme. Më pas duke përdorur metodën e incidenteve kritike ne iu kemi qasur përfitimit të informacioneve nga bizneset lidhur me përfitimet që kanë nga auditimi i pasqyrave financiare.

Gjetjet nga literatura dhe rastet e incidenteve kritike të përftuara nga intervistat na kanë shërbyer për hartimin e pyetësorit kërkimor. Të gjitha këto na kanë ndihmuar në identifikimin e faktorëve ndikues në

përcaktimin e bizneseve për auditimin e pasqyrave financiare, gjegjësisht përfitimet që kanë ndërmarrjet nga auditimi i pasqyrave financiare. Rezultatet e këtij studimi do të kenë ndikime të shumëfishta pozitive, veçmas në:

- Nxjerrjen në pah të nevojës për auditimin e vazhdueshëm të pasqyrave financiare
- Ngritjen e transparencës në lidhje me afarizmin e bizneseve dhe pasqyrat financiare të tyre dhe joshjen e investitorëve të mundshëm si rezultat i saj.
- Krijimin e evidencës empirike për ndikimin e secilit nga përfitimet e bizneseve në auditimin e pasqyrave financiare.

## II. Rishikimi i literaturës

Literatura e cila studion përfitimet e bizneseve nga auditimi, mbështet dobishmërinë e bizneseve nga auditimi i pasqyrave financiare. Me këtë çështje janë marr hulumtues të shumtë të cilët kanë ardhur në përfundime se nga auditimi i pasqyrave financiare ndërmarrjet kanë përfitime të shumta, si:

Auditimet ndikojnë në besueshmërinë e informacionit financiar duke zvogëlon rrezikun e investimit (Fallatah, 2008).

Monitorimi i entitetit nga audituesit nxit menaxhmentin të angazhohet në monitorimin e brendshëm duke përmirësuar kështu sistemin e kontrollit të brendshëm (Ghosh, 2007). Auditimi i jep besueshmëri pasqyrave financiare duke zvogëluar pasigurinë dhe rrezikun (Broadley, 2006). Institucionet kredidhënëse i konsiderojnë informacionet e audituesit si informacione relevante dhe të dobishme për vendimmarrje për investime dhe për kredidhënie (Guillamon, 2003).

Investitorët dhe bizneset në tërësi kanë nevojë për informacione financiare të besueshme dhe në këtë kontekst audituesi luan një rol kyç në mbrojtjen e interesit publik dhe të investitorëve (Elorrieta, 2002).

Auditimi mundëson përmirësimin e gabimeve në pasqyrat financiare (Hylas dhe Ashton, 1982).

## III. Metodologjia

Me qëllim të identifikimit dhe operacionalizimit të koncepteve është përdorur metoda e incidenteve kritike, e cila ndërthet në vete një tërësi procedurash që karakterizohen me mbledhjen e të dhënave nga vëzhgimet e drejtpërdrejta të sjelljeve njerëzore. Metoda e incidenteve kritike ka për qëllim të ofrojë bazë empirike për zgjidhjen e problemeve praktike.

Incident do të thotë çdo veprim i dukshëm njerëzor i përfunduar deri në atë masë që mundëson interferencën dhe parashikimin për personin që kryen atë veprim.

Përshtypjet e menaxherëve të entiteteve lidhur me auditimin janë në masë të madhe përjetim i përvojës së tyre, prandaj edhe përfitimi nga auditimi mbështetet në përjetimin e brendshëm subjektiv.

Përdorimi i metodës së incidenteve kritike ka shërbyer për identifikimin e temave kryesore që aktualizohen kur klientët vlerësojnë dobishmërinë e auditimit të pasqyrave financiare.

### 1. Intervistat për identifikimin e incidenteve kritike

Për mbledhjen e informacioneve të nevojshme kemi përdorë intervistat, për kryerjen e të cilave kemi angazhuar kolegët nga profesioni që punojnë në punët e kontabilitetit dhe të auditimit, të cilët kanë intervistuar pronarët/menaxherët e ndërmarrjeve me qëllim të marrjes së përgjigjeve relevante në lidhje me pyetjet e parashtruara në formularin e intervistës.

Në lidhje me këtë janë intervistuar 31 pronarë / menaxherë të ndërmarrjeve të cilët janë lutur të përgjigjen në një pyetje identike:

***“Cili është përfitimi i ndërmarrjes Tuaj nga auditimi i pasqyrave financiare?”***

Kërkimet cilësore të bëra përmes intervistave na kanë ndihmuar në zbulimin e shumë incidenteve kritike ku janë theksuar rastet konkrete të përfitimeve të ndërmarrjeve si rezultat i auditimit të pasqyrave financiare.

Nga intervistat e zhvilluara janë mbledhur gjithsej 41 raste të incidenteve kritike (Tab.1, Fig.1), prej të cilave në dhjetë raste respondentët janë përgjigjur se auditimi i pasqyrave financiare rritë besueshmërinë e informacioneve të cilat i përmbajnë pasqyrat financiare, që në total përbën 24.39 % të incidenteve kritike të gjetura. Zbulimi i gabimit i cili bëhet me rastin e auditimit është theksuar në gjashtë raste dhe në totalin e incidenteve kritike merr pjesë me 14.63 %.

Rastet e incidenteve kritike në lidhje përmirësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, marrjen e kredisë dhe përmirësimi i strukturës së pasurive qarkulluese si rezultat i auditimit janë theksuar në nga katër raste.


Përmirësimi i strukturës së pasurive fikse dhe përmirësimi i politikave kontabël që mundësohet nga auditimi kanë nga tri raste të gjetjeve.

Përfitimi i granteve qeveritare dhe përfitimi i investimeve si rezultat i auditimit të pasqyrave financiare është theksuar në nga dy raste të incidenteve. Gjetjet tjera janë raportuar në tri raste të incidenteve kritike.

Rastet e incidenteve kritike të mbledhura i kemi klasifikuar në tema të ndryshoreve të pavarura (përfitimet konkrete nga auditimi) dhe një temë që përfaqëson ndryshoren e varur (auditimi i pasqyrave financiare).

	Numri i incidenteve kritike	%
Përmirësimi i gabimit	6	14.63
Përfitim i grantit	2	4.88
Përfitim i investimeve	2	4.88
Marrja e kredisë	4	9.76
Përmirësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm	4	9.76
Shtimi i besueshmërisë së pasqyrave financiare	10	24.39
Përmirësimi i strukturës së mjeteve xhiruese	4	9.76
Përmirësimi i politikave kontabël	3	7.32
Përmirësimi i strukturës së mjeteve themelore	3	7.32
Të tjera	3	7.32
<b>Gjithsej</b>	<b>41</b>	<b>100</b>

**Tabela 1.** Përfitimet që nxisin bizneset të auditojnë pasqyrat e tyre financiare



**Figura 1.** Përfitimet që nxisin bizneset të auditojnë pasqyrat e tyre financiare

## 2. Hipotezat e studimit

Për hartimin e hipotezave jemi bazuar në rastet e incidenteve kritike të fituara nga intervistat e zhvilluara me pronarët/menaxherët e ndërmarrjeve të

intervistuar dhe rastet e gjetjeve të mëparshme nga rishikimi i literaturës relevante të kësaj lëmie.

Përfitimet e bizneseve nga auditimi i pasqyrave financiare	t	Shkallet e lirise	Sig.	$\bar{X}$
Rritja e besueshmërisë së pasqyrave financiare	57,32	57	,000	6,60
Marrja e granteve	34,86	57	,000	5,00
Joshja e investimeve	40,00	57	,000	5,50
Marrja e kredive	34,02	57	,000	5,29
Marrja e tenderëve	56,83	57	,000	6,40
Përmirësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm	53,66	57	,000	6,50
Rritja e sigurisë afariste të biznesit	34,48	57	,000	5,31
Përmirësimi i politikave kontabël	49,88	57	,000	6,19
Përmirësimi i strukturës së mjeteve kryesore	38,57	57	,000	6,00
Përmirësimi i strukturës së mjeteve xhiruese	23,98	57	,000	4,00
Përmirësimi i gabimeve	29,34	57	,000	5,00
Zbulimi i shpërdorimeve	34,29	57	,000	5,40

**Tabela 2.** Pritjet për përfitimet nga auditimi midis ndërmarrjeve që i auditojnë pasqyrat financiare

Hipotezat kryesore të këtij studimi janë:

H-1=Ndërmarrjet e audituara kanë pasqyra financiare më të besueshme.

H-2=Auditimi mundëson përmirësimin e kontrollit të brendshëm të ndërmarrjeve.

H-3=Auditimi mundëson përmirësimin e gabimeve.

H-4=Auditimi ndihmon në përfitimet e investimeve të jashtme.

H-5=Auditimi mundëson marrjen e kredive bankare me kushte të volitshme.

H-6=Auditimi mundëson marrjen e tenderëve të ndryshëm.

H-7=Auditimi ndihmon në marrjen e granteve qeveritare.

H-8=Auditimi mundëson përmirësimin e strukturës së mjeteve kryesore.

H-9=Auditimi mundëson përmirësimin e politikave kontabël.

H-10=Auditimi mundëson zbulimin e mashtrimeve në ndërmarrje




Figura 2. Vlerat mesatare të pritjeve të bizneseve për përfitimet nga auditimi

Qarkullimi vjetor (Eur)	Prodhuese	Ndërtimore	Tregtare	Të tjera	Biznes individual	Ortakëri	Sh.p.k.	Nr. i respondentëve	% e respondentëve
Deri 500.000		2	2		4			4	6,90
500.000-1.000.000	2	4	1	2	2		7	9	15,50
1.000.000-2.000.000	3	7	4	1	3		13	16	27,60
Mbi 2.000.000	6	16	7	1	1	2	26	29	50,00
<b>Totali</b>	<b>11</b>	<b>29</b>	<b>14</b>	<b>4</b>	<b>10</b>	<b>2</b>	<b>46</b>	<b>58</b>	<b>100,00</b>

Tabela 3. Ndërmarrjet e intervistuar sipas madhësisë, sektorit dhe formës organizative

### 3. Anketa

Të dhënat e fituara nga intervistat e zhvilluara me metodën e incidenteve kritike dhe gjetjet e mëparshme nga rishikimi i literaturës relevante të kësaj lëmie na kanë shërbyer si bazë për hartimin e pyetësorit kërkimor. Në pjesën e parë të pyetësorit janë dhënë pyetjet e nxjerra nga hipotezat tona dhe në ato pyetje respondentët janë lutur të japin përgjigjen duke bërë vlerësimin në bazë të shkallës së pajtueshmërisë së tyre me pyetjen e bërë nga 1 deri 7. Në pjesën e dytë të pyetësorit janë dhënë pyetjet në lidhje me auditimin ku është kërkuar përgjigje kategorike(po ose jo) lidhur me atë se ndërmarrjet e respondentëve a e bëjnë auditimin e pasqyrave financiare, a e bëjnë atë rregullisht, a do t’ia preferonin ndonjë partneri ta bënte auditimin, a do ta bëjnë auditimin vitin e ardhshëm etj. Në pjesën e tretë të pyetësorit janë parashtruar pyetjet lidhur me vitin e themelimit, formën e organizimit, qarkullimin vjetor,

sektorin ku veprojnë, etj. Pyetësori kërkimor i është dërguar 105 ndërmarrjeve kosovare, me të cilin rast pronarët/menaxherët e tyre kanë bërë plotësimin e tij në prezencë të kërkuarit. Gjithsej janë kthyer 58 pyetësor të vlefshëm për studim.

Anketimi është bërë në qytete të ndryshme të Kosovës(Prishtinë, Prizren dhe Pejë), duke zgjedhur ndërmarrjet më të mëdha të sektorëve të ndryshëm(Tab.3). Sipas formës së organizimit Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar i janë përgjigjur më së shumti anketimit ku nga gjithsej 58 respondent 46 janë të tilla. Sipas madhësisë shumica e respondentëve janë ndërmarrje të mesme dhe të mëdha, gjë që është e arsyeshme sepse ndërmarrjet e mëdha janë të interesuara më tepër për të audituar pasqyrat financiare. Sipas sektorëve shumica e respondentëve janë nga ndërtimtaria që arsyetohet me faktin se për ndërtimtarët kërkohen pasqyrat

financiare të audituara me rastin e konkurrimit për marrje të punës.

#### IV. Analiza e të dhënave

Për analizimin e të dhënave kemi përdorë pakon softuerike SPSS. Të dhënat janë në përputhje me gjetjet nga literatura dhe intervistat paraprake.

Analiza deskriptive e të dhënave tregon se hipotezat e parashtruara janë mbështetur nga të dhënat e fituara nga kërkimi empirik. Të dhënat e fituara tregojnë se të gjitha hipotezat kanë një vlerë mbi mesataren (Tab.2 dhe Fig.2). Kështu, shtimi i besueshmërisë së pasqyrave financiare si rezultat i auditimit është vlerësuar nga respondentët me mesatare prej 6.60 nga vlerësimi maksimal 7 i mundshëm. Përmirësimi i kontrollit të brendshëm të ndërmarrjes si rezultat i rekomandimeve nga auditimi është vlerësuar me 6.50. Marrja e tenderëve si rezultat i auditimit është vlerësuar gjithashtu me mesatare të lartë prej 6.40. Përmirësimi i politikave kontabël të ndërmarrjes dhe përmirësimi i strukturës së pasurive fikse si rezultat i auditimit janë vlerësuar me mesatare 6.20 respektivisht 6.0.

Joshja e investimeve si rezultat i auditimit vlerësohet me mesatare prej 5.50. Zbulimi i shpërdorimeve me rastin e auditimit nga respondentët është vlerësuar me mesatare prej 5.40. Marrja e kredive dhe rritja e sigurisë afariste të ndërmarrjeve si rezultat i auditimit është vlerësuar me mesatare prej 5.30. Përmirësimi i gabimeve si rezultat i auditimit është vlerësuar me mesatare 5.0 dhe në fund përmirësimi i strukturës së mjeteve xhiruese si rezultat i auditimit me mesatare të vlerësuar 4.0.

Nga të dhënat e lartshënuara shihet se të gjitha hipotezat tona janë vlerësuar lartë mbi mesataren ashtu si i kemi përshkruar më lartë.

Analiza e të dhënave tregon se pritjet e ndërmarrjeve për përfitimet nga auditimi i pasqyrave financiare ndikojnë fuqishëm në përcaktimin e tyre për ti audituar ato.

#### V. Gjetjet kryesore të studimit

Gjetjet nga ky punim tregojnë se klientët e vlerësojnë auditimin bazuar në përfitimet që kanë nga auditimi i pasqyrave financiare. Shtimi i besueshmërisë së pasqyrave financiare si rezultat i auditimit të tyre është gjetja më e rëndësishme e këtij studimi duke i vënë ndërmarrjet e audituara në përparësi të shumta në krahasim me ato të cilat nuk i auditojnë pasqyrat financiare. Këto përparësi shprehen në përfitimet tjera që kanë ndërmarrjet me pasqyra financiare të audituara në joshjen e investimeve të jashtme dhe marrjen e kredive me kushte të volitshme.

Përmirësimi i strukturës së pasurive fikse dhe përmirësimi i strukturës së pasurive qarkulluese janë gjetje të rëndësishme për vazhdimin e afarizmit të biznesit duke e liruar atë nga mjetet e panevojshme të cilat në të ardhmen do ti shkaktonin humbje.

Përmirësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm si rezultat i rekomandimeve nga audituesi është gjetje tjetër e rëndësishme e cila ka dal nga të dhënat e fituara nga studimi ynë.

Përmirësimi i gabimit si rezultat i auditimit të pasqyrave financiare nga ana e audituesit është gjetje e radhës e cila ka ndikim në zvogëlimin e shpenzimeve dhe mbarëvajtjen e veprimtarisë së biznesit.

Zbulimi i shpërdorimeve në ndërmarrje sjell efekte të dobishme për ndërmarrjen e audituar dhe palët e interesuara për afarizmin e saj.

Përmirësimi i politikave kontabël të ndërmarrjes dhe rritja e sigurisë afariste të ndërmarrjes si rezultat i auditimit janë gjetje gjithashtu me rëndësi të veçantë për afarizmin e suksesshëm të ndërmarrjes.

Gjetjet tona janë në përputhje me hulumtimet e mëparshme, si në vijim:

Auditimi i jep besueshmëri pasqyrave financiare duke zvogëluar pasigurinë dhe rrezikun (Broadley, 2006).

Auditimet cilësore ndikojnë në besueshmërinë e informacionit financiar i cili zvogëlon rrezikun e investimit (Fallatah, 2008).

Investitorët dhe bizneset kanë nevojë për informacione të besueshme, kështuqë audituesi luan një rol kyç në mbrojtjen e interesit publik dhe të investitorëve (Elorrieta, 2002).

Monitorimi i jashtëm i entitetit nga audituesit ndikon në përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të tij (Ghosh, 2007).

Raporti i audituesit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm jep informacion të rëndësishëm për vendimmarrësit e investimeve (Shelton & Whittington, 2008).

Auditimi ndihmon në gjetjen e gabimeve në raportet financiare (Hylas & Ashton, 1982). Institucionet kredidhënëse i konsiderojnë informacionet nga raportet e audituesve si informacione relevante dhe të dobishme (Guillamon, 2003).

Opinionit i audituesit ka ndikim të madh në gjasat për kredimarrje (Firth, 1980).

Rezultatet e kërkimeve tona mbështesin edhe hipotezat lidhur me përfitimet e tenderëve dhe granteve si rezultat i auditimit, por nuk kemi gjetur kërkime të mëparshme të cilat do t'i mbështetnin ato. Lidhur me këto dy hipoteza mendojmë se janë rezultat i rrethanave specifike kosovare.

## VI. Kufizimet e studimit

Studimi ynë bazohet në hulumtimet e bëra nga këndvështrimi i pronarëve dhe menaxherëve të bizneseve, sepse intervistat i kemi zhvilluar me ta dhe kemi marr perceptimet e tyre lidhur me dobishmërinë e auditimit të pasqyrave financiare. Por, lidhur me informacionet që paraqiten në pasqyra financiare, siç kemi theksuar në fillim të këtij punimi, janë të interesuar edhe shumë palë tjera dhe do të ishte shumë e rëndësishme që të studiohen edhe perceptimet e tyre lidhur me këtë çështje. Studimet e ardhshme mund ta hulumtojnë këtë lëmi nga këndi i shfrytëzuesve tjerë të informacioneve nga pasqyrat financiare, si: kreditdhënësit, investitorët, institucionet shtetërore, punëtorët e ndërmarrjeve, analistët e ndryshëm e tjerë.

## VII. Përfundimi dhe rëndësia

Ky studim ofron evidencë empirike që vërteton gjetjet e studiuesve të mëparshëm se auditimi i pasqyrave financiare ndikon në:

- Shtimin e besueshmërisë së informacioneve nga pasqyrat financiare, duke ndihmuar vendimmarrësit që të vendosin për veprimet e tyre ekonomike të ardhshme duke u bazuar pikërisht në informacionet e besueshme financiare të vërtetuara përmes opinionit të audituesit.
- Përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të ndërmarrjes, i cili bëhet përmes zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga audituesi ndikon në mbarëvajtjen e afarizmit të ndërmarrjeve dhe arritjen e objektivave të menaxhmentit lidhur me funksionimin me sukses të ndërmarrjes duke ulur shpenzimet e panevojshme dhe duke rritur fitimin.
- Joshjen e investimeve të jashtme nga partnerë të ndryshëm si rezultat i besueshmërisë së informacioneve financiare që dalin nga pasqyrat financiare të audituara.
- Marrjen e kredive me kushte të volitshme si në pikëpamje të shkallës së interesit ashtu edhe të afatit të kthimit të kredisë, duke ndikuar kështu në uljen e shpenzimeve të interesit dhe mundësimin e një afarizmi më të suksesshëm.
- Përmirësimin e strukturës së pasurive fikse të ndërmarrjes, duke hequr mjetet jofunksionale dhe të padobishme.
- Përmirësimin e politikave kontabël të ndërmarrjes bazuar në standardet e kontabilitetit të cilat e rregullojnë këtë lëmi.
- Përmirësimin e gabimeve në pasqyrat financiare të ndërmarrjes, duke zvogëluar kështu shpenzimet të cilat pasojnë si rezultat i ndëshkimeve dhe kamatave

që aplikohen nga Administrata Tatimore për raste të tilla.

- Zbulimin e shpërdorimeve të ndryshme në ndërmarrje, duke mbrojtur kështu ndërmarrjen nga përvetësimi i paligjshëm i pasurive të saj nga individët e pandërgjegjshëm.

Studimi ka identifikuar edhe dy faktorë të veçantë ndikues në arsyen për auditim të pasqyrave financiare të cilët nuk i kemi hasur në literaturën e deritanishme:

- Marrja e granteve të ndryshme si rezultat i auditimit, dhe
  - Marrja e tenderëve si rezultat i auditimit të pasqyrave financiare
- Këto dy gjetje i kemi cilësuar si rezultat i rrethanave specifike kosovare.

Bazuar në rezultatet e këtij studimi mund të vijmë në përfundim se nga auditimi i pasqyrave financiare bizneset kanë përfitime të shumta. Ky studim do të kontribuoj në rritjen e transparencës afariste të bizneseve, në promovimin e praktikës së auditimit të pasqyrave financiare dhe vënien në pah të nevojës për auditim të vazhdueshëm të pasqyrave financiare.

## VIII. Literatura

- Broadley D. (2006), Auditing and its role in Corporate governance, FSI Seminar on Corporate Governance for Banks.
- Elerroita A. M. (2002), Disclosure and Transparency Accounting and Auditing, The Third Meeting of the Latin American Corporate Governance Roundtable, OECD & World Bank Group.
- Fallatah Y. (2008), The role of asset reliability and auditor quality in equity valuation, Global Conference on Business & Economics.
- Firth M. (1980), A note on the impact of audit qualifications on lending and kredit decisions, Journal of Banking & Finance, Vol. 4,
- Ghosh S. (2007) External Auditing, Managerial Monitoring and Firm Valuation: An Empirical Analysis for India, International Journal of Auditing
- Guillamon, A. G. (2003), The usefulness of the audit report in investment and financing decisions, Managerial Auditing Journal
- Hylas, E. R. & Ashton H. R. (1982), Audit Detection of Financial statement Errors, The Accounting Review, Vol. LVII, No.4 .
- Shelton, W. S. & Whittington O. R. (2008) The influence of the auditor's report on investors' evaluation after the Sarbanes-Oxley Act, Managerial Auditing Journal.

**PYETËSORI KËRKIMOR**

Jemi duke bërë studimin me titull: "Përfitimet e bizneseve nga auditimi i pasqyrave financiare". Ju lutemi të na ndihmoni në këtë projekt duke u përgjigjur në pyetjet në vijim.

*I. Ju lutem shprehni mendimin tuaj në lidhje me përfitimet që mund të ketë biznesi juaj nga auditimi i pasqyrave financiare duke u përgjigjur në të gjitha pyetjet në vazhdim. Nëse plotësisht pajtoheni me deklaratën rrethoni 7, nëse aspak nuk pajtoheni rrethoni 1. Natyrisht, ju mund të rrethoni edhe njërin nga numrat 2, 3, 4, 5, 6, varësisht prej shkallës së pajtueshmërisë Tuaj.*

*I. Auditimi i pasqyrave financiare mundëson:*

1. Rritjen e besueshmërisë së pasqyrave financiare	1 2 3 4 5 6 7
2. Marrjen e granteve	1 2 3 4 5 6 7
3. Joshjen e investimeve	1 2 3 4 5 6 7
4. Marrjen e kredive	1 2 3 4 5 6 7
5. Marrjen e tenderëve	1 2 3 4 5 6 7
6. Përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm	1 2 3 4 5 6 7
7. Rritjen e sigurisë afariste të biznesit	1 2 3 4 5 6 7
8. Përmirësimin e politikave kontabël	1 2 3 4 5 6 7
9. Përmirësimin e strukturës së mjeteve kryesore	1 2 3 4 5 6 7
10. Përmirësimin e strukturës së mjeteve xhiruese	1 2 3 4 5 6 7
11. Përmirësimin e gabimeve	1 2 3 4 5 6 7
12. Zbulimin e shpërdorimeve	1 2 3 4 5 6 7

*II. Ne jemi të interesuar të dimë në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare në firmën tuaj (përgjigjuni me po ose jo):*

13. A e bënë ndërmarrja juaj rregullisht auditimin e pasqyrave financiare ?	
14. A i ka audituar ndërmarrja juaj pasqyrat financiare në vitin e fundit ?	
15. A jeni të kënaqur me përfitimet nga auditimi i pasqyrave financiare ?	
16. A e bëni auditimin vetëm në raste kur kërkohet nga ndonjë institucion ?	
17. A do t'i auditojë ndërmarrja juaj pasqyrat financiare vitin e ardhshëm ?	
18. A ndikon cilësia e auditimit në përfitimet e biznesit ?	
19. A ndikon çmimi i auditimit në cilësinë e tij ?	
20. A ndikon çmimi në vendimin tuaj për auditimin e pasqyrave financiare ?	
21. A janë të informuar sa duhet bizneset lidhur me përfitimet nga auditimi ?	
22. A do t'i preferonit kolegëve tuaj që ta bëjnë auditimin e pasqyrave financiare ?	

*III. Ne gjithashtu jemi të interesuar për disa të dhëna për biznesin tuaj*

- a. Viti i themelimit \_\_\_\_\_
- b. Qarkullimi vjetor \_\_\_\_\_
- c. Lloji i biznesit: 1. Individuale; 2. Ortakëri; 3. Sh.p.k.
- d. Lloji i veprimtarisë-sektori \_\_\_\_\_
- e. Drejtuesi(menaxheri)-përgatitja shkollore \_\_\_\_\_

*Ju faleminderit për kohën e harxhuar dhe për ndihmesën e dhënë për projektin ton.*